

VENDIM
Nr. 126, datë 23.3.2000

**PËR PËRBËRJEN DHE PROCEDURAT E PUNËSIMIT TË KOMISIONIT TË POSAÇËM
PËR SHPRONËSIMET**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11, të ligjit nr.8561, datë 25.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, me propozimin e ministrit të Punëve Publike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Komisioni i posaçëm, për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit, krijohet me urdhër të ministrit që mbulon veprimtarinë në objektin për të cilin paraqitet kërkesa për shpronësim dhe përbëhet nga jo më pak se 5 anëtarë. Kryetari i komisionit të posaçëm caktohet zëvendësministri i ministrisë përkatëse.

2. Në komision përfshihen, sipas përkatësisë, nëpunës ose specialistë të pavarur, me përvojë dhe kualifikim të posaçëm për vlerësimin e objektit që shpronësohet, të tillë si ekonomistë, juristë, inxhinierë e agronomë, të cilët nuk kanë asnjë lidhje farefisnore me pronarët dhe nuk janë palë të interesuara në pronat që shpronësohen.

3. Gjatë veprimtarisë komisioni i posaçëm ndjek këtë procedurë pune:

- Studion dhe verifikon kërkesën e paraqitur nga subjekti i interesuar për shpronësim për interesa publike dhe, në rast se kërkesa dhe dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë ose i saktë, komisioni e kthen për plotësim, duke caktuar edhe afat për plotësimet përkatëse. Për rastet kur kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues nuk paraqiten në afatin e caktuar ose gjenden të pambështetura, për mungesë të shkakut ose të kushteve të shpronësimit, kërkesa hidhet poshtë, gjë që i njoftohet menjëherë kërkuarit të shpronësimit.

- Kur vërtetohet se kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues janë në pajtim me kushtet dhe kriteret e parashikuara në ligj dhe në aktet nënligjore, përkatëse, komisioni vendos për pranimin e kërkesës për shpronësim dhe njofton menjëherë, me shkrim, subjektin kërkuar, në favor të të cilit bëhet shpronësimi, dhe lidh marrëveshje për të drejtat dhe detyrimet e ndërsjellta për procedurën e shpronësimit, e cila është titull ekzekutiv.

- Njofton drejtpërdrejtë, brenda 10 ditësh nga data e lidhjes së marrëveshjes, secilin pronar a bashkëpronar të pasurive pronë private, që kërkohen të shpronësohen ose zhvlerësohen si dhe personat e tretë, për shpronësimin e tyre. Njoftimi bëhet në mbështetje të dispozitave, të vendimit të Këshillit të Ministrave, që rregullojnë procedurën e njoftimit për shpronësim.

- Bën publikimin e kërkesës për shpronësim për interes publik.

- Kryen veprime për identifikimin dhe vlerësimin përfundimtar, si dhe bën përlogaritjen e masës së shpërblimit për objektet që shpronësohen. Vlerësimi i pasurive pronë private, që shpronësohen, zhvlerësohen apo shpërblehen, bëhet në bazë dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave për kriteret e vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive të mësipërme.

- Përgatit propozimin për shpronësim, së bashku me dokumentacionin, sipas nenit 20 të ligjit përkatës për shpronësimet, i cili i paraqitet Këshillit të Ministrave nga ministri përkatës.

- Në rast kundërshtimi të shpronësimit, nga Këshilli i Ministrave përgatitet dokumentacioni për kthimin e fondeve të depozituara për procedurën e shpronësimit.

4. Shpërblimi i anëtarëve të komisionit të posaçëm caktohet me urdhër të ministrit që krijon këtë komision.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta